



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR	
MINISTARSTVO ZHIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA	
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING	
Njësia Org. Org.Jednica Org.Unit	01-M
Nr.Prot. Broj.Prot. Prot.No.	1838/26
Nr i faqeve Broj.stranica No.pages	02
Data Datum Date	08.04.2026
PRISHTINE/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Zivotne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment, Spatial and Planning

Nr.07/2026

Datë: 08.04.2026

Ministrja e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 93 paragrafit 4 të Kushtetutës së Kosovës, në përputhje me nenin 11 nënparagrafi 1.5 i Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.34/2022), të nenit 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 Për Organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.7/2019), nenin 17 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i Rregullores Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, në nenin 6, 13, 71 dhe dispozitave të tjera të Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/2013), në mbështetje të nenit 5 paragrafi 2 dhe 3 si dhe të nenit 6 të Ligjit nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 50/2009), nenin 8 paragrafi 2 dhe nenin 9 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 të Ligjit NR.08/L-209 Për Investime të Qëndrueshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.17/2024), dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011) i ndryshuar dhe plotësuar, si dhe në Udhëzimin Administrativ të MMPH-së nr.03/2018 Për Procedurat për Leje Ujore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Urdhërohet pezullimi i përkohshëm i të gjitha punimeve në shtretërit e lumenjëve për projektet ekzistuese në të cilat përdoret beton. Ky pezullim vlen për segmentet të cilat nuk kanë përfunduar 90% të punës së këtyre projekteve.
Kontratat ekzistuese do të përshtaten në atë mënyrë që MMPH, në bashkëpunim me autoritetet implementuese, do të sigurojë zbatimin e kritereve që mbrojnë mjedisin dhe natyrën.
2. Ndalohet planifikimi, projektimi, miratimi, financimi dhe lëshimi i pëlqimeve ujore për çdo projekt të ri që parasheh betonimin e shtretërve të lumenjve, përveç atyre me autorizim të veçantë nga MMPH. Të gjitha projektet e ardhshme për rregullimin e lumenjve duhet të hartohen ekskluzivisht në përputhje me Ligjin.
3. Ministria iniciacionin procesin e bashkëpunimit me Komunat, në cilësinë e Autoriteteve Kontraktuese, dhe operatorët ekonomikë për rishikimin e projekteve të pezulluara.



4. Ndryshimin e paramasave dhe paralogarive për segmentet e mbetura, duke siguruar që mjetet e zotuar financiare të realizohen përmes metodave që mbrojnë ekosistemin lumor.
5. Obligohet Inspektorati Qendror i Mjedisit, Ujërave, Natyres, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit dhe Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore (ARPL), Divizioni i Prokurimit, Komunitat si dhe institucionet e tjera përkatëse, të mbikëqyrin zbatimin e këtij vendimi në terren dhe të ofrojnë asistencën e nevojshme teknike për Komunitat gjatë fazës së përshtatjes së projekteve.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Ministria ka konstatuar se praktikatat e deritashme të rregullimit të shtretërve të lumenjve përmes betonimit kanë çuar në degradimin e pakthyeshëm të ekosistemeve ujore. Përdorimi i betonit eliminon shkëmbimin e ujërave nëntokësorë, shkatërron habitatet e florës dhe faunës lumore dhe rrit shpejtësinë e rrjedhës, duke shkaktuar rrezik më të lartë nga vërshimet në zonat e poshtme.

Ky pezullim si më lartë nuk cenon substancën e kontratave ekzistuese, por kërkon përshtatjen e tyre teknike me standardet mjedisore në fuqi, duke garantuar që mjetet publike të shpenzohen në projekte që nuk dëmtojnë mjedisin.

Përshtatja e projekteve përmes aplikimit të metodave ekologjike dhe materialeve natyrore në vend të betonit siguron që investimet e Komunave të jenë të qëndrueshme, të rrisin rezistencën ndaj vërshimeve dhe të jenë në harmoni të plotë me Direktivat Evropiane për Ujërat, të cilat Kosova synon t'i përafrojë.

Bashkëpunimi me Komunitat iniciohet me qëllim të rishikimit të projekteve zbatuese dhe ndryshimin e paramasave dhe paralogarive për segmentet e mbetura. Pjesa e projekteve që janë në zhvillim e sipër do të bëhen me praktika dhe materiale të përshtatshme me mjedisin (gurë natyrorë, mbrojtje natyrore të brigjeve, mbjellje të drunjëve dhe shkurreve), të cilat mbrojnë shtratin në mënyrë natyrale. Mjetet e zotuar financiare të realizohen nga operatorët ekonomikë, duke siguruar njëkohësisht mbrojtjen e ekosistemit lumor.

Nga sa u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Kabinetit të Ministres të MMPH-se;
- Sekretari i Përgjithshëm;
- Inspektorati i Ministrisë;
- ARPL;
- Divizioni për Komunikim Publik;
- Divizioni i Prokurimit;
- Të gjitha Komunave;
- Arkivi i MMPH-së.


Edita Pacolli Dalipi
Ministre e Ministrisë së Mjedisit dhe
Planifikimit Hapësinor